

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Burim Shala dhe Bujar Muzaqi, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses E.E., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor SH.E., e këtë e përfaqëson i autorizuari S.M., avokat nga Vitia, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar N.B., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C.nr.398/2012, të datës 30.09.2015, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur me datë 06.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C.nr.398/2012, të datës 30.09.2015, në pikën I të dispozitivit përkitazi me dëmin jo material për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike dhe gjykohet si vijon: **DETYROHET** e paditura që paditësit ti paguaj në emër të kompensimit për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike t’ia paguajë shumën prej 1.500 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar për këtë kategori të dëmit, **REFUZOHET SI E PABAZUAR**.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurës, **NDRYSHOHET** aktgjykimi Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C.nr.398/2012, të datës 30.09.2015, në pjesën e kërkesëpadisë sa i përket kamatës së gjykuar dhe gjykohet: **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, që paditëses për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t’ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 30.09.2015, e deri në pagesën definitive.

II. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti C.nr.398/2012, të datës 30.09.2015, në pjesën tjetër të kërkesëpadisë, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.398/2012, të datës 30.09.2015, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses E.E. nga fshati .., Komuna e Vitisë. Me pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë që në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datën 26.06.2012, ta kompenzon paditësen për këto baza: Në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për 30 minuta shumë prej 1.500 €, për dhimbje fizike të intensitetit të rëndë për 24 orë shumë prej 500 €, për dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 14 ditë shumë prej 500 €, për shëmtim të shkallës së lehtë shumë prej 1.000€, në emër të frikës të intensitetit të lartë për 6 muaj shumë prej 800 €, në emër të frikës të intensitetit të ulët për 12 muaj shumë prej 500 €, gjithsej për dëmin jo material shumë prej 4.800 €. Në emër të dëmit material për ndihmën e huaj për 14 ditë shumë prej 100 €, në emër të ushqimit të përforcuar për 21 ditë shumë prej 150 €, në emër të shpenzimeve të shërimit dhe barna shumë prej 223.65 €, gjithsejt shumë prej 473,65 €.

Me pikën III të dispozitivit e ka obliguar të paditurën Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" që t'ia kompensojë paditëses dëmin prej 5.273,65 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit me kamat 8% për dëmin jo material duke filluar nga data 30.09.2015, ndërsa për dëmin material nga data 27.12.2012 deri në pagesën përfundimtare. Me pikën IV të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për pjesën tjetër të padisë në shumë prej 8.416,00, si e pa bazuar.

Kundër këtij e paditura në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që aktgjykimin e shkallës së parë ta prishë dhe lëndën t'ia kthejë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësja me propozim bërë Gjykatës së Apelit që ankesën e të paditurës ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja E.E. nga fshati Terpez, Komuna e Vitisë, nëpërmes përfaqësuesit ligjor, e ky nëpërmes përfaqësuesit të tij me datë 27.12.2012, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve

"Kosova e Re" me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë me qëllimi të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave përmes: raportin mjekësor të Emergjencës në Ferizaj të datës 26.06.2012, raportin specialistik të Shërbimit Ambulantor i përpiluar nga Dr.N.H.-neurokirurg i datës 29.06.2012 si dhe raporti specialistik i të njëjtit shërbim i datës 05.09.2012, raporti i Klinikës Ortopedike "Gjeneza" në Ferizaj i datës 05.09.2012 i përpiluar nga Dr.B.I.-Ortoped Traumatolog, raportet ortopedike të të njëjtës klinikë të datës 13.07.2012, 04.07.2012, 21.07.2012, 06.08.2012 dhe 18.10.2012 të lëshuar nga Dr.N.H.-neurokirurg, raporti i mjekësisë fizikale dhe rehabilitim në Kllkot i datës 07.08.2012 në shumën prej 630 €, certifikata e lindjes për paditësen L02166840, e datës 04.07.2012, kuponat fiskal prej 25 copave në vlerë prej 233 € për pagesa për barna dhe kontrolla mjekësore, aktgjykimi penal i Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1999/2012, i datës 16.10.2013, ekspertizën dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit të datës 06.12.2012, të përpiluar nga A.A. dhe pas vlerësimit të provave të lartcekura e konform nenit 8, 323 paragrafi 1 dhe 2, 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenet 173, 183 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, për shkak se aktgjykimi përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket dëmit jo material për dhimbjet fizike, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për dëmin jo material për dhimbjet fizike pasi që vlerësoj se shumica e gjykuar nuk ishte në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimi. Në çdo rast për dëmin jo material gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimit tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarën.

Mbi këtë bazë gjykata duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësja, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, si dhe rrethanat tjera si moshën e re të paditësesh dhe praktiken e mirë gjyqësore për këtë lloj të dëmit vendosi si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i ka pranuar pretendimet ankimore të paditurës sa i përket shumës së gjykuar për dëmin jo material për dhimbje fizike, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe mendimin profesional dhe konstatimin e eksperteve gjyqësor nga lëmia e mjekësisë Dr.XH.S.-Ortoped-Traumatolog dhe Dr. SH.H.-Psikiatër, mendime këto të dhëna në seancën e datës 15.09.2015, kjo gjykatë vlerëson se shumica e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë është shumë e lartë dhe nuk është në përputhje me praktikën gjyqësore, andaj bazuar në të lartcekurat Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këtë kategori të dëmit Gjykata e Apelit vlerëson se përtej kësaj shume, nuk është në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi, andaj edhe të njëjtat i ka refuzuar si të pabazuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pjesës së vërtetuar të aktgjykimi për frikën e përjetuar, e njëjta në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lehta të lëndimeve që ka pësuar paditësja, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së

kompensimit siç janë: natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës si dhe rrethanat tjera si moshë e re e paditëses si dhe praktika gjyqësore rezultojnë se shumica e gjykuar është në përputhje me qëllimin e kompensimit, andaj edhe ka vendosur që ta vërtetojë aktgjykimin e ankimuar sa i përket dëmit jo material për frikën e përjetuar.

Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, Gjykata e Apelit, vlerësoj se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse nevojën për këto dy kategori të dëmit e kanë përcaktuar ekspertët ndërsa lartësia e gjykuar është brenda limiteve të pranuar nga praktika gjyqësore, për shkak se këtë ndihmë dhe ushqimin e përforcuar paditësja zakonisht e merrë nga familjarët e tyre, ndërsa sa i përket shpenzimeve të shërimit, Gjykata e Apelit ka vendosur që ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë për këtë kategori të dëmit material, pasi që paditësja ka ofruar prova materiale-kupona me të cilat vërtetohet se paditësja ka krijuar shpenzime për shërimin e saj.

Aktgjykimi është ndryshuar edhe sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën tre të dispozitivit të këtij aktgjykimi e duke iu referuar nenit 277 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), dhe (e) e lidhur me nenin 200 dhe 201 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.98/2016, me datë 06.02.2019

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,

Ac.nr.98/2016

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt.06.02.2019, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 140.1 të LPK-së.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

V ë r t e t o j n ë:

Anëtarët e kolegjit

**Kryetari i kolegjit
Ramë Hyseni**

Burim Shala

1. _____

Bujar Muzaqi

2. _____